



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 318, datë 29.12.2020

PËR SHFUQIZIMIN E PJESSHËM TË UDHËZIMIT TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM NR. 12, DATË 20.07.2020.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, sot, në Tiranë, më datë 29.12.2020, shqyrtoi në seancë plenare publike çështjen që i përket:

ANKUES Albert Kuliçi, me detyrë prokuror në prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i neneve 12 pika 3, 13, 14, 15 pika 1, 16 pika 2, 17 pikat 1 dhe 2, 18 dhe 21, të udhëzimit nr.12 datë 20.07.2020 "Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm".

BAZA LIGJORE: Kushtetuta e Shqipërisë.

Kodi i Procedurave Administrative.

Ligji Nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar.

Ligji Nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar.

Ligji Nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Ligji Nr. 97/2012 "Për organizmin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".

Ligji nr. 7895, datë 27.01.1995, "Kodi i Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

Ligji nr. 7905, datë 21.03.1995, "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË,

u njoh me relacionin dhe rekomandimin relatorit të çështjes z. Bujar Sheshi, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

Çështja që paraqitet për shqyrtim është iniciuar mbi bazën e ankesës së e prokurorit Albert Kuliçi, administruar pranë KLP, me nr.1384 prot, datë 14.09.2020.

Ankuesi nëpërmes objektit të ankesës kërkon nga KLP shfuqizimin e neneve 12/3, 13, 14, 15/1, 16/2, 17/1/2, 18 dhe 21 të Udhëzimit të Përgjithshëm nr.12, datë 20/07/2020 “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”, të Prokurorit të Përgjithshëm.

Çështja u pranua dhe u mor në shqyrtim nga Këshilli mbi bazën e pikës 1, të nenit 47, të Ligji 97/2016 për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë i cili përcakton se:

“Prokurori mund të kundërshtojë paligjshmërinë apo pabazueshmërinë e udhëzimeve të përgjithshme, duke bërë ankim në Këshillin e Lartë të Prokurorisë”.

Udhëzimi objekt ankimi, është miratuar me datë 20.07.2020 dhe ka hyrë në fuqi në datën 07.09.2020.

II. PRETENDIMET E ANKUESIT

Ankuesi Albert Kuliçi, ka parashtruar me shkrim në ankim faktin se:

Pasi është njohur me udhëzimin objekt ankimi, çmon se disa prej dispozitave të tij bien ndesh me ligjin dhe për këtë arsye në ushtrim të së drejtës që i nje ligji, kërkon nëpërmjet këtij ankimi shfuqizimin e neneve 12 pika 3, 13, 14, 15 pika 1, 16 pika 2, 17 pikat 1 dhe 2, 18 dhe 21 të këtij udhëzimi.

Në mënyrë të përmbledhur ankuesi pretendon se vendosja e detyrimit të prokurorit, për të njoftuar drejtuesin e Prokurorisë pa kërkesën paraprake të këtij të fundit, në lidhje me regjistrimin, ecurinë, vendimin e gjykatës, ankimin, apo edhe veprimet hetimore që pritet të kryhen në një procedim penal, përbëjnë tejkalim të kompetencave të sanksionuara nga ligji procedural penal, duke cënuar në këtë mënyrë pavarësinë e prokurorit gjatë ushtrimit të ndjekjes penale.

III. VLERËSIMI I KËSHILLI TË LARTË TË PROKURORISË

1. Këshilli pranoi për shqyrtim çështjen mbi përfundimet e rëna dakord se:

Objekti i mosmarrëveshjes përbën lëndë juridiksioni administrativ dhe se ajo hyn në kompetencën lëndore e funksionale të Këshillit referuar pikës 1, të nenit 47, të Ligji 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë”, mbi bazën e të cilit Këshilli shqyrton kërkesat apo ankimet në

lidhje me paligjshmërinë apo pabazueshmërinë e udhëzimeve të përgjithshme të prokurorëve më të lartë.

Nga verifikimin rezultoi se ky udhëzim i është njoftuar drejtuesve të prokurorive në vend me datë 23.07.2020, si dhe i është shpërndarë në rrugë elektronike dhe kopje fizike edhe prokurorëve. Sikurse përcaktohet në nenin 24, ky udhëzim ka hyrë në fuqi me datë 07.09.2020. Ankesa është administruar në KLP, me datë 14.09.2020. Bazuar në nenin 132, i Kodit të Procedurave Administrative, kjo ankesë vlerësohet se plotëson kriteret formale lidhur me afatin ligjor të paraqitjes së saj, për shkak se ky ankim është paraqitur brenda afatit 30 ditor nga data e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi. Pika 1, e nenit 132, përcakton se “Ankimi administrativ ndaj aktit administrativ duhet të paraqitet brenda 30 ditëve nga data kur ankuesi ka marrë njoftim për nxjerrjen ose refuzimin e nxjerrjes së aktit administrativ”. Vlerësimi mbi plotësimin e këtij kriteri formal u bë në mbledhjen plenare të Këshillit të datës 15.11.2020.

Për sa më sipër gjendet i pranueshëm për shqyrtim në aspektin formal procedural kërkimi i ankuesit për shfuqizimin e neneve 12 pika 3, 13, 14, 15 pika 1, 16 pika 2, 17 pikat 1 dhe 2, 18 dhe 21, të udhëzimit nr.12 datë 20.07.2020 “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”.

Ndërkohë nga ana e Prokurorit të Përgjithshëm është nxjerrë një Udhëzim i Përgjithshëm me nr 16 datë 14.12.2020 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e Përgjithshëm Nr 12 datë 20.7.2020 (objekt ankimi), duke ndryshuar nenet 13;14;15;17;18 dhe 21 të udhëzimit të mëparshëm.

Konstatohet se me hyrjen në fuqi të këtyre ndryshimeve, organi i ngarkuar me ligj për të shqyrtuar ankimin, pra KLP, ndodhet përpara pamundësisë për t’u shprehur për këto dispozita të Udhëzimit meqenëse mungon objekti i ankesës, por dhe qëllimi i marrjes në shqyrtim të ankimit për të cilin ishte nisur kjo procedurë.

Në këto kushte, bazuar në parashikimin e nenit 95, të Kodit të Procedurave Administrative, Këshilli vlerëson se objekt i shqyrtimit të ankesës mbeten vetëm nenet 12 dhe 16 të Udhëzimit, pasi për nenet 13;14;15;17;18 dhe 21 të udhëzimit, mungon objekti dhe qëllimi i ankimit meqenëse janë ndryshuar nga ana e vetë organit që ka nxjerrë aktin administrativ.

2. Në lidhje me dispozitat e ankimuar, Këshilli vlerëson se:

Është detyrë e Këshillit që shqyrton ankesën, që të kuptojë drejt natyrën e saj, shkakun ligjor të kërimit, përcaktimin e drejtë të ligjit të zbatueshëm dhe si rezultat, të vendosë mbi kërkesën, në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme të zbatohen prej saj, pa u lidhur me përcaktimin që mund të propozojë ankuesi. Ky detyrim buron nga parimi i ligjshmërisë në vendimmarrjen administrative, sanksionuar në nenin 4 të “Kodit të Procedurave Administrative”.

Autoriteti vlerësues i Këshillit mbështetet në premisën e evidentimit dhe analizimit të funksioneve publike atribuar me ligj organit publik (në rastin konkret drejtuesit të prokurorisë), në raport me kompetencën rregullatore bazë për veprimin që kundërshtohet. Në vlerësimin e ligjshmërisë apo

bazueshmërisë të aktit nënligjor, sikurse është edhe udhëzimi objekt ankimi, mbahet parasysh fakti që akti nënligjor del në bazë dhe për zbatim të ligjit që normon një marrëdhënie të caktuar, marrëdhënie e cila kërkohet të saktësohet apo të rregullohet në mënyrë më të detajuar nëpërmjet një akti nënligjor.

Evidentimi i të drejtës apo interesit të ligjshëm përligj njëherësh të drejtën e Këshillit për udhëzimin e organit administrativ dhe rivendosjen e së drejtës së shkelur.

Nëpërmjet këtij Udhëzimi, Prokurori i Përgjithshëm ka synuar të unifikojë të drejtat dhe detyrimet e prokurorëve në ushtrimin e funksioneve, marrëdhëniet me drejtuesit e prokurorive si prokurorë më të lartë dhe informimin e koordinimin në veprimtarinë e prokurorisë, për të siguruar pavarësinë dhe autonominë e prokurorit në ushtrimin e funksioneve, duke qartësuar kuptimin dhe zbatimin në praktikë të disa çështjeve ligjore që lidhen me respektimin e parimeve të ligjshmërisë, detyrueshmërisë së ndjekjes penale për përmirësimin e veprimtarisë organizative dhe funksionale apo procedurale në prokurori, por pa cenuar parimin e pavarësisë së prokurorëve në hetimin dhe përfaqësimin në gjyq të çështjeve konkrete.

Ky udhëzim në përgjithësi i përmbahet në mënyrë korrekte parashikimeve Kushtetuese dhe atyre ligjore, konkretisht të drejtave por dhe detyrimeve të prokurorëve të normuara në ligjin nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” si dhe Kodit të Procedurës Penale. Në pjesën më të madhe dispozitat e Udhëzimit janë të njëjta me ato që ligji parashikon por duke i përdorur këto përcaktime ligjore për të normuar fusha të veçanta të aktivitetit të prokurorisë për grup çështjesh të caktuara, për shkak të rëndësisë së veçantë që ato paraqesin.

Për ato dispozita të udhëzimit nr .12 datë 20.07.2020, për të cilat Këshilli ka detyrimin të shpërehet me vendim përfundimtar, nenet 12, pika 3 dhe 16 pika 2, vlerësohet se ankimi nuk gjen mbështetje ligjore.

KONKRETISHT:

Në lidhje me nenin 12, pika 3 e Udhëzimit,

Parashikimet e nenit 12 të Udhëzimit lidhen me dispozitat e nenit 43, 48 dhe 52, të ligjit nr. 97/2016, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Prokurorisë”.

Ankuesi pretendon se nëpërmjet kësaj dispozite është bërë i detyrueshëm njoftimi i drejtuesit të prokurorisë nga ana e zëvendës drejtuesit, apo drejtuesit të seksionit, që janë të gatshëm për çdo kërkesë drejtuar gjykatës lidhur me arrestimet në flagrancë, ndalimet, masat e sigurimit personal dhe/ose pasuror.... etj.

Në fakt në Udhëzim, neni 12, pika 3 e aktit që kundërshtohet nuk ka të bëjë me njoftimin e drejtuesve të prokurorisë nga zëvendës drejtuesi, apo nga drejtuesi i seksionit, pasi kjo pikë e udhëzimit bën fjalë për informimin e drejtuesit nga prokurori për shkaqet e kthimit të akteve nga gjykata mbi një çështje dhe ecurinë e mëtejshme të hetimit për këtë çështje, duke theksuar “mbi kërkesën e drejtuesit”. Në këtë drejtim ky parashikim është në përputhje me parashikimet nenit 43, të ligjit 97/2016. Pra ndërtimi dhe formulimi i këtij neni është bërë sipas përcaktimit të ligjit dhe njëkohësisht i shërben kryerjes së detyrës funksionale të drejtuesit të prokurorisë, sepse më së paku

kthimi i çështjes nga gjykata, ka lidhje të drejt për drejtë me vlerësimin periodik të punës së prokurorit, i cili bëhet nga drejtuesi i prokurorisë.

Shkaqet e paraqitura në ankim në lidhje me Nenin 12, pika 3, në fakt lidhen me Nenin 12, pika 4, të Udhëzimit, i cili thotë "4. Zëvendës drejtuesi i prokurorisë apo drejtuesi i seksionit, që janë të gatshëm sipas grafikut të gatishmërisë, duhet të njoftojë drejtuesin e prokurorisë për çdo kërkesë drejtuar gjykatës lidhur me arrestimet në flagrancë, ndalimet, masat e sigurimit personal dhe/ose pasuror, mjetet për kërkimin e provës, sigurimin e provës, për aktet drejtuar institucioneve të vuajtjes së dënimit me burgim, masat mjekësore apo shërbimeve policore, të cilat nënshkruhen nga zëvendës drejtuesi i prokurorisë ose drejtuesi i seksionit, në mungesë të drejtuesit të prokurorisë."

Në vlerësim të këtij neni të udhëzimit, Këshilli gjykon se parashikimet e pikës 4 të nenit 12, përbëjnë kërkesa që nuk bien në kundërshtim me ligjin. Këto parashikime janë logjike dhe normale, pasi lidhen me mënyrën e organizimit të brendshëm të punës në prokurori dhe nuk kanë lidhje me çështjen konkrete por me detyrimin që zëvendës drejtuesit dhe/ose drejtuesit e seksioneve që nënshkruajnë aktet në emër të drejtuesit dhe me autorizim të tij, të informojnë atë për aktet që kanë nënshkruar në emër të drejtuesit. Ky nen nuk përmban asnjë rrethanë që të cenojë pavarësinë e prokurorëve dhe as nuk përmban detyrime për ta.

Si konkluzion pretendimi i ankuesit në lidhje me nenin 12, pika 3 apo 4 nuk qëndron, pasi gjendet i pabazuar.

Në lidhje me nenin 16, pika 2, të Udhëzimit me titull "Delegimi i kompetencave dhe informimi i zëvendës drejtuesit në prokurori".

Pretendimet e ankuesit në lidhje me këtë pikë, kanë të bëjnë me detyrimi i prokurorëve që të informojnë paraprakisht dhe pa kërkesë zëvendës drejtuesin e prokurorisë në rast mungesë të drejtuesit dhe pranë drejtuesit të seksionit, duke e çmuar këtë parashikim si në kundërshtim me nenet 42, 43, germa "b" dhe 52, pika 2 të ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".

Në fakt parashikimi i pikës 2 të nenit 16, ndryshe nga sa pretendohet në ankim, nuk bën fjalë për drejtuesit e seksioneve por vetëm për ato të zëvendës drejtuesit. Nga ana tjetër parashikimi në këtë pikë që "Në mungesë të drejtuesit të prokurorisë, prokurori është i detyruar t'i përgjigjet kërkesave të zëvendës drejtuesit", nuk bie në kundërshtim me ligjin sa kohë që përcaktohet se në mungesë të drejtuesit, kompetencat e tij i kalojnë zëvendës drejtuesit. Për më tepër në këtë nen theksohet qartë që prokurorët duhet të informojnë zëvendës drejtuesin në mungesë të drejtuesit, sipas kërkesës që do të bëjë vetë zëvendës drejtuesi.

Pra edhe pretendimi i ankuesit në lidhje me nenin 16, pika 2, të Udhëzimit gjendet i pabazuar në ligj.

PËR KËTO ARSYE,

Në përfundim të shqyrtimit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë bazuar në nenet 149, pika 1, 149/a, pika 1, germa e), të Kushtetutës, në nenet 95, 113, pika 1, 136, pika 4, të Kodit të Procedurave

Administrative, në nenet, 164, pika 8, 166, pika 2, 189, pika 3, dhe 190, pika 4, të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar,

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës së ankuesit për shfuqizimin e neneve 12 dhe 16 të Udhëzimit Nr. 12, datë 20.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokuroreve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”.
2. Deklarimin e përfundimit të procedurës administrative pa vendim përfundimtar, filluar mbi bazën e ankimit Nr 1384 Prot, datë 14.09.2020 të prokurorit Albert Kuliçi, me objekt shfuqizimin e pjesshëm të udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm Nr. 12, datë 20.07.2020, “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokuroreve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”, vetëm sa i takon neneve 13, 14, 15 pika 1, , 17 pikat 1 dhe 2, 18 dhe 21.
3. Ky vendim i njoftohet brenda 5 ditëve ankuesit dhe Prokurorit të Përgjithshëm.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KRYETARI

GENT IBRAHIMI

